

V E N D I M
Nr.585, datë 5.12.1994

**PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE PUBLIKE NË PËRDORIM TË INSTITUCIONEVE
DHE ENTEVE TË ADMINISTRATËS SHETËTËRORE DHE PËR RAPORTIMET
FINANCIARE PERIODIKE E VJETORE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I :

1. Në të gjitha njësitë organizative buxhetore me bilanc më vete të kryhet inventarizimi fizik i pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme gjendje në mbyllje të ushtrimit financiar 1994, që ndodhet në administrim të tyre, duke përfshirë edhe objektet ose sendet që u janë dhënë në përdorim subjekteve të tjera shtetërore a private.

Inventarizimi fizik i pasurisë të kryhet nga komisione të posaçme, të ngritura me urdhër me shkrim të titullarit të njësisë organizative me bilanc më vete.

2. Të gjitha njësitë organizative buxhetore me bilanc më vete të verifikojnë dhe të marrin në llogari për vitin 1994 të gjitha detyrimet debitore e kreditore që kanë me të tretët, qofshin këta persona fizikë apo juridikë.

Çdo person juridik a fizik që është kreditor ndaj një njësie organizative buxhetore, duhet t'u paraqitë këtyre të fundit, brenda datës 28 shkurt 1995, shumën e detyrimit që kërkon të shoqëruar me dokumentet justifikuese të nevojshme (faturë, titull ekzekutiv etj.)

3. Çdo njësi organizative buxhetore me bilanc më vete duhet të hartojë, brenda datës 31 mars 1995, bilancin kontabël dhe anekset e tij për ushtrimin financiar 1994.

Bilancet kontabël do të depozitohen në degët e thesarit të rrethit, ku njësia organizative buxhetore ka selinë e saj.

4. Çdo njësi organizative buxhetore me bilanc më vete të organizojë për vitin 1995 e në vazhdim mbajtjen e një kontabiliteti të rregullt dhe përgatitjen e balanceve periodike e vjetore, sipas udhëzimeve të nxjerra nga ministri i Financave.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen titullarët e çdo njësie organizative me bilanc më vete.

Organet e kontrollit shtetëror, qendrore e lokale, ushtrojnë kontroll për zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim dhe nxjerrin, kur është rasti, përgjegjësinë për titullarin e njësisë organizative me bilanc më vete.

6. Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi dhe të përcaktojë rregulla më të hollësishme për mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe depozitimin e llogarive periodike e vjetore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi